



Nr. 771 -Regj.

Tiranë më 12.07.2021

Lenda : Kërkohej heqja e shënimit të bllokimit të aktiveve (kuotat) të pales-debitore

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Për dijeni : **Sh" Meat Master Vllezerit Kimca" sh.p.k dhe shoqëria " V.M.K sh.p.k**
: **Raiffeisen Bank sh.a**

Pranë shërbimit përmbarimor "Power & Justice" (P&J) sh.p.k me kërkesë të palës kreditore janë paraqitur për ekzekutim titujt ekzekutiv me palë:

Kreditor : Raiffeisen Bank sh.a

Debitor : Shoqëria "Dizzoti" sh.p.k Sh" Meat Master Vllezerit Kimca" sh.p.k

Dorëzanes : Eduard Rrotani, Ardjan Kimca dhe Cesk Kimca

Me objekt : Kthim Shume (Kredi Bankare)

Une përmbaruesi gjyqësor Ilir Dervishaj pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbarimore

KONSTATOVA

Në titullin ekzekutiv titullit Kontratë Kredite Bankare Nr. 2589 rep, nr. 1320 kol, datë 13.07.2012 të ndryshuar, është përcaktuar detyrimi i palës debitore Shoqëria "Dizzoti" sh.p.k bashkredimarrësit Sh" Meat Master Vllezerit Kimca" sh.p.k si dhe palëve dorëzanëse Eduard Rrotani, Ardjan Kimca dhe Cesk Kimca, të paguajnë në favor të palës kreditore Raiffeisen Bank sh.a shumën e marrë kredi së bashku me interesa në masën 603.323.41 Euro. Për këtë titull ekzekutiv nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar Urdhëri i ekzekutimit Nr.642 Akti, datë 05.02.2016 si dhe pala kreditore ka kërkuar ekzekutimin e tij. Në këto kushte në bazë të ligjit është përgatitur dhe dërguar me shërbimin postar njoftimi për ekzekutim vullnetar ndaj palës debitore dhe atyre dorëzanëse. Por nga ana e shërbimit të Postës Shqiptare zarfat janë kthyer mbrapsh dhe për rrjedhojë me cilësinë e përmbaruesit gjyqësor është vajtur në Buashat Shkodër ku është bërë dhe komunikimi i akteve palës debitore dhe atyre dorëzanëse. Më pas pala debitore që nga marrja e njoftimit vullnetar e deri me sot nuk është vepruar dhe për rrjedhojë afati për ekzekutim vullnetar ka përfunduar. Në këto kushte ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm duke urdhëruar vendosjen e masës së sekuestros mbi llogaritë e palës debitore në Bankat e Nivelit të Dytë si dhe në bazë të nenit 560 të K.Pr.Civile është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros mbi pasuritë e paluajtëshme të palës debitore të vendosur si garanci në hipoteke në favor të palës kreditore "Raiffeisen Bank" sh.a. Por pala debitore shoqëria Sh" Meat Master Vllezerit Kimca" sh.p.k ka garantuar palën kreditore me "Kontrate Mërveshje Siguruese mbi kuotat e pjesamrjes në shoqëri" me numur 2601 Rep Nr.1323 Kol date 13.07.2012 me kuotat në masën 70 % që ka pala debitore pranë shoqërisë "VMK" sh.p.k Në këto kushte është e nevojshme që të vendosej shënimi i bllokimit të aktiveve të shoqërisë që ka pala debitore në shoqërinë "V.M.K" sh.p.k me numur NIPTI K 96624002 B të regjistruara në Qendren Kombëtare të Biznesit me qëllim mospjetërsimin e tyre. Pala kreditore Raiffeisen Bank sh.a me shkresën nr.29610 prot, ka kërkuar pezullimin e urdhërit të

ekzekutimit në ngarkim të palëve debitoare pasi ndërmjet tyre është arritur marrëveshje ripagimi për shlyerjen e detyrimit me këste. Por me pas nga ana e perfaqësuesve të pales kreditore është kërkuar vazhdimi i ekzekutimit pasi pala debitoare nuk e ka respektuar marrëveshjen e aritur. Në keto kushte është marrë vendimi i rifillimit të ekzekutimit si dhe bazuar në nenin 615 e vijues të K.Pr.Civile ishte e nevojshme të vazhdohej procedura atje ku ishte lënë në kryerjen e veprimeve të ekzekutimit të detyrueshëm. Për këtë është urdheruar vendosja e masës së sekuestros në llogarin e pales debitoare, si dhe janë vepruar me veprimet proceduriale për pasurinë e palujtshme të lënë si garanci në momentin e marrjes së kredise. Me pas pala e kane bërë marrëveshje për shlyerjen e detyrimit dhe perfaqësuesit e pales kreditore kanë kërkuar pezullimin e veprimeve përmbartimore. Nga ana e jone është vepruar sipas nenit 615 të K.Pr.Civile me pezullim të ekzekutimit. Me pas pala kreditore ka paraqitur shkresën nr.15434 prot date 07.07.2021 ku ka kërkuar pushimin e ekzekutimit dhe për rjedhojë nga ana e jone është marrë vendimi i ppushimit të ekzekutimit. Në keto kushte duhet të hiqen dhe sekuestrot e vendosura nga ana e jone.

Për këto arsye :

Në bazë të Nenit 617 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 26/2019 "Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat".

URDËHËROJ

- **Heqjen e shënimit të bllokimit vendosur nga ana e jone "Mbi aktivet (kuotata) e shoqëriës "V.M.K" sh.p.k me NUIS K 46818008 U, me administrator Z. Klaudio Kimca, me seli në Bushat Shkoder, në masën 70% që ka pala debitoare Sh "Meat Master Vllëzerit Kimca" sh.p.k", pasi ekzekutimi i urdherit ekzekutiv është pushuar me kërkesë të pales kreditore**
- **Heqjen e shënimit të bllokimit vendosur nga ana e jone "Për bllokimin e aktiveve të palës debitoare Shoqëria "Dizzoti" sh.p.k me numur niptit K 46818008.U, perfaqësuar nga ortakut dhe administratori i shoqërisë Znj. Enrisa Ritani, me seli në Bushat Shkoder pasi ekzekutimi i urdherit ekzekutiv është pushuar me kërkesë të pales kreditore**
- **Heqjen e shënimit të bllokimit vendosur nga ana e jone të palës debitoare Shoqëria Sh "Meat Master Vllëzerit Kimca" sh.p.k me Nipt K 06527025 T sh.p.k me numur niptit K 46818008 U, perfaqësuar nga ortakut dhe administratori i shoqërisë Cesk Kimca, me seli në Zona Industriale Shkoder, pasi ekzekutimi i urdherit ekzekutiv është pushuar me kërkesë të pales kreditore**

Në rast se mbi keto aktive të shoqërisë ka bllokime të tjera të vendosura nga përmbartues ose institucione të tjera ato nuk hiqen mbetën në fuqi.

Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Për personat që behen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin 606 e vijues të K.Pr.Civile.

Ky urdhër u njoftohet QKB si dhe palëve të eilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë brenda 5 ditëve nga marrja e dijeni.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin mbetimi në pritje të veprimit tuaj.

PËRMBARTUESI GJYQËSOR

Ilir S. DERVISHAJ

